



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 932 Date 27.12.2008

PER

PRISHJEN E SHOQERISE "SHTEPIA BOTUESE NAIM FRASHERI" SH.A
TIRANE DHE SHPALLJEN E SAJ NE LIKUIDIM

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë; nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, për dësa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore ne Shoqëri Tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore; Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", për shkak te situatës se rende ekonomiko-financiare, humbjen e objektit kryesor te punës, me cilësinë e zotëruesit te 100% te aksioneve ne shoqërinë "Shtëpia Botuese Naim Frasheri" Sh.a Tirane.

URDHEROJ:

1. Prishjen e shoqërisë "Shtëpia Botuese Naim Frasheri" Sh.a Tirane dhe shpalljen e saj ne likuidim.
2. Lirimin nga detyra te drejtorit te shoqërisë Z. Bahri Myftari dhe caktimin si likuidatore Zj. Mereme Berisha me profesion ekonomiste.
3. Lirohet nga detyra Këshilli Mbikqyrës i "Shtëpia Botuese Naim Frasheri" Sh.a Tirane dhe emërohet Këshilli i ri mbikqyrës i shoqërisë ne likuidim i përbërë nga:
 - Stavri Dhima përfaqësues i METE
 - Mirela Shehri përfaqësuese e METE
 - Hava Sula përfaqësuese e METE
4. Te hartohet dokumentacioni ne përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".
5. Ngarkohet likuidatorja e shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit"

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENC RULI

Adresa: Shkollë "Deshmorët e Kombit" No. 2
E-mail: sewa@kre.gov.al
Internet: <http://www.kre.gov.al>



Tel: + 355 4 218467
Tel: + 355 4 223158
Fax: + 355 4 214652



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE
DREJTORIA E SHERBIMEVE TE BRENDSHME

Selefr



URDHER

Nr. 44 Date 17.01 2010

PER

**LIRIM DHE EMËRIM LIKUIDATORI NE SHOQERINE
SHTEPJA BOTUESE "NAIM FRASHERI" SH.A. NE LIKUIDIM**

TIRANE

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë; nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem te Asamblese se shoqerise:

URDHEROJ :

1. Lirimin nga detyra te likuidatorit te Sh.A Shtepia Botuese "Naim Frasheri" Tirane, Znj. Mereme Berisha.
2. Shkeputja e marrdhenieve financiare te behet sipas legjislacionit ne fuqi.
3. Emerohet ne detyren e likuidatorit te Sh.A Shtepia Botuese "Naim Frasheri" Tirane, Z. Ilirjan SHMILI.
4. Mardheniet financiare fillojne me paraqitjen ne detyre.
5. Ngarkohet shoqëria Shtepia Botuese "Naim Frasheri" sh.a. ne likuidim Tirane, për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit"

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

Doritan Prifti
DORITAN PRIFTI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE MBESHTETESE
DREJTORIA E SHERBIMEVE TE BRENDSHME

URDHE R

Nr. 176 date 3/3 / 2010

PER

LIRIM DHE EMERIM LIKUIDATORI

Mbeshtetur ne Nenin 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04, 2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date, 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", i ndryshuar, neni 191 e ne vijim, te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ne cilesine e zoteruesit te vetem te aksioneve te shoqerise ;


URDHEROJ :

1. Lirimin e z. Ilirjan Shmili nga detyra e Likuidatorit te Sh.a Shtepia Botuese "Naim Frasheri".
2. Rimerimin e znj. Mereme Berisha, ne detyren e Likuidatorit te Sh.a Shtepia Botuese "Naim Frasheri".
3. Marredheniet financiare per z. Ilirjan Shmili, te rregullohen sipas legjislacionit te fuqi.
4. Marredheniet financiare per znj. Mereme Berisha, fillojne me paraqitjen ne detyre.
5. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerise te beje ndryshimet perkatese ne aktet juridike, ne perputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit".

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

DRITAN PRIFTI



Handwritten notes:
Naim Frasheri
Mereme Berisha
19.4.2010